
Pogradec, me 05.02.2026

PROCES-VERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Projekt zbatim rindërtimi i kompleksit shkollor “Koli
Gusho” dhe “Muharrem dhe Esat Minarolli”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Projekte:22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 666 666, 66 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: “Buxheti i Shtetit” me VKB-në Nr.98, datë 04.11.2025 “Për miratimin e fondeve për investime të ndryshme” dhe të detajuar me shkresën e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar më datë 19.11.2025.

Argumentimi i fondit limit: Fondi limit është përlllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (D.P.K.ZH.T) pranë Bashkisë Pogradec dhe i është vënë në dispozicion njësisë së prokurimit, me anë të shkresës ,me lëndë: “Dorezim dokumenacioni per fillim procedure prokurimi per projektet e zbatimit”, të cilët kanë përgatitur detyrën e projektimit si dhe përlllogaritjen e fondit limit,për këtë objekt. Gjatë përlllogaritjes së fondit limit specialistë e fushës kanë mbajtur në konsideratë Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku thuhet se:1. Në *përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

a) *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*

b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*

c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Gjithashtu, specialistët e fushës në përlllogaritjen e fondit limit i janë referuar njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017, ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave

Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar si dhe në llogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale për objektin në fjalë ka rezultuar që fondi limit të ketë vlerën prej 6 666 666, 66 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit pa TVSH.

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Gjithashtu bazuar në nenin 43 paragrafin 1 dhe në pikën b) të paragrafit 2 të këtij neni në VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku thuhet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare"

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ekstraktit të QKB-se.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën ,vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 20 % të vlerës së fondit limit, për shërbime të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; ose fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të cilat i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari të ngjashme dhe i ka përmbyllur me sukses këto

sherbime, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur sherbimin që prokurohet nga autoriteti kontraktor.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të cilat, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari të ngjashme pranë subjekteve private dhe i ka përmbyllur me sukses këto sherbime të ofruara, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur sherbimin që prokurohet nga autoriteti kontraktor.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

Kat 2. PROJEKTUES ARKITEKT

2. b. 2 Qendra Tregtare; Objekte social – kulturore; objekte kulti; objekte arsimore..

2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Kat 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

3.a. Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

3.d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike

Kat 4. PROJEKTUES INSTALATOR

4.a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare

4. b. Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4.f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit

4.i-. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

4.j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial.

Kat 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

5.b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkim

Kat 8. PROJEKTUES GJEODET

8.a- Rivelime inxhinierike.

Kat 9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

9.a Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate

Kat 12 . STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Liçensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për çdo kategori si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
2.PROJEKTUES ARKITEKT	Kat. 2. b. 2 Qendra Tregtare; Objekte social – kulturore; objekte kulti; objekte arsimore	<i>Projektuesi arkitek harton planimetritë e kateve, lartësitë e tyre, planin e përgjithshëm, fasadat, shtresat e ndryshme. Përcakton lartësitë e dyerve-dritareve dhe llojin e tyre. Gjithashtu bën përzgjedhjen e llojit të bojës hidroplastike për fasaden dhe lyerjet e brendshme.</i>
	Kat. 2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.	<i>Projektuesi arkitekt bën projektimin e peizazhit , sistemim e sipërfaqeve të gjelberta të shkollës dhe sistemimin e jashtëm të tyre.</i>
3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR	3.a. Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Projektuesi kontraktor bën vlerësim të strukturave ekzistuese të objektit. Projekti konstruktiv është themelor, për të siguruar që objekti të jetë i qëndrueshëm, i sigurt dhe funksional për përdorim afatgjatë për nxenesit të cilët do të mesojnë në ato godina.
	3.d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.	Projektuesi konstruktor bën planin e themeleve ,planin e strukturave beton arme, muraturen mbajtëse ose ndarëse. Për të gjitha këto duhet të llogaritet kapaciteti mbajtës i themeleve dhe i strukturave beton arme. Kjo kategori nevojitet për objektin shtesë , i cili do të ndërtohet në kompleksin shkollor.
4. PROJEKTUES INSTALATOR	Kat. 4.a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare	Projektuesi instalator përcakton instalimit hidro-termosanitare që nevojiten në kompleksin shkollor ekzistues si dhe në shtesë objektit sipas detyrës së projektimit.
	Kat.4.b. Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.	Projektuesi duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.
	Kat.4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	Projektues instalator të linjës së rrjetit elektrik sipas detyrës së projektimit.

	Kat.4.f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit	Projektim instalator te sistemit kundra zjarrit sipas detyres se projektimit.
	4.i-. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.	Projektim i ndricimit te ambjenteve te brendshme dhe te jashtme te kompleksit shkollor.
	Kat.4.j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial.	Projektuesi duhet te hartoje projektin sipas detyres se projektimit e cila kerkon projektimin e rrjetit te telefonise, internetit, sistemin e alarmit , sistemin e mbrojtjes nga zjarri si dhe shkallet e emergjences ne kompleksin shkollor.
5. PROJEKTUES VEPRÄ HIDRAULIKE	Kat 5.b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkim	Projektuesi duhet te hartoje projektin sipas detyres se projektimit me hartimin e projektit duke siguruar, që rrjeti i ujrave te bardha dhe te zeza te pershtaten dhe me rrjetin ekzistues te kompleksit shkollor.
8.PROJEKTUES GJEODET	Kat 8.a- Rilevime inxhinierike.	Rilevime inxhinierike per te gjithë ketegorige e objekteve subjekt te kesaj procedure si dhe per objektin shtese qe pritet te realizohet.
9.STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOL GJIK	Kat 9.a Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate	Referuar detyrës së projektimit, projektuesi duhet të bëjë studimin e gjendjes aktuale të objektit duke patur parasysh nënshtresat hidrogeologjike duke shmangur pasojat që mund të lindin nga burimet nëntokësore. Studim dhe vlerësim i gjeologjisë së truallit ku ndodhet objekti ekzistues dhe raportet për masat që duhet të merren në bazë të studimit. Hartimin e raportit mbi qëndrueshmërinë e tokës dhe evidentimin e zonave problematike të paraqitura në mënyrë skematike.
12.STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE	Kat b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore	Referuar detyrës së projektimit, projektuesi sizmolog duhet të bëjë studimin sizmologjik te gjendjes aktuale të objektit si dhe te objetit shtese qe do te parashikojë kompleksi shkollor.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi Konstruktor
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Topograf
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Për stafin e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV si dhe te figurojnë ne listepagesa per muajin e fundit te deklaruar.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas shtojces 5.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Specialisti i fushës për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të dhe pikave te licenses te kerkuara ne piken 2.3.2.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për stafin si më poshtë:

1(nje) projektues Arkitekt- Gjykohet i nevojshem sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar 2. b. 2 Qendra Tregtare; Objekte social – kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore dhe pikes 2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Arkitekti vleresohet i nevojshem sipas detyres se projektimit per te hartuar planimetrit e kateve, lartesite e tyre, planin e pergjithshem, fasadat, shtresat e ndryshme. Percakton lartesite e dyerve-dritareve dhe llojin e tyre. Gjithashtu ben perzgjedhjen e llojit te bojës hidroplastike per fasaden dhe lysterjet e brendshme.

Ndersa sipas licesces me kategori 2.d- gjykohet i nevojshem per projektimin e peizashit, sistemim e siperfaqeve te gjelberta te shkolles dhe sistemimin e jashtem te tyre.

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi Konstruktor -Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar 3.a. Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate; 3.d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike; si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, I ndryshuar , duke hartuar projektin e zbatimit dhe relacionet përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit dhe duke siguruar që ato të jenë te realizueshme ekonomikisht dhe teknologjikisht.

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat 4.a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; Kat.5.b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkim dhe detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”,i ndryshuar , realizon projektimin e veprave hidroteknike duke siguruar që rrjeti i ujrave te bardha dhe te zeza te projektohen sipas kushteve moderne dhe te pershtaten dhe me rrjetin ekzistues te kompleksit shkollor.

1 (nje) Inxhinier Gjeodet /Topograf;

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat. 8.a) - Rilevime inxhinierike si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar , duke hartuar rilevimet përkatëse. Inxhinieri gjeodet për projektimin e kompleksit shkollor ka rendesi për sigurinë dhe saktësinë e ndërtimit pasi siguron matje të sakta të terrenit dhe mundëson planifikimin dhe projektimin e godines në përputhje me realitetin gjeografik të zonës.

1(nje) projektues Inxhnier Gjeolog

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat 9.a Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trualtit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate; si dhe detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”,i ndryshuar , per te hartuar raportet e detajuara për karakteristikat e terrenit dhe ndikimin që mund të kenë ato në projektin e infrastrukturës duke studiuar dhe analizuar karakteristikat gjeologjike të terrenit ku ndërtohet rruga. Kjo përfshin analiza të dheut, shkëmbinjëve dhe ujërave nën sipërfaqe për të vlerësuar stabilitetin dhe sigurinë e mundshme gjatë ndërtimit dhe përdorimit të rrugës. Gjithashtu inxhinieri gjeolog identifikon dhe vlerëson mundësinë e fenomeneve natyrore të tilla si rrëshqitje dheu, përmbytje dhe tërmete të cilat ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës

- 1 (nje) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik

Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat b-Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore; si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”,i ndryshuar , per te hartuar raportet e detajuara për karakteristikat e terrenit dhe ndikimin që mund të kenë ato në projektin e infrastrukturës duke studiuar dhe analizuar karakteristikat sizmologjike të terrenit ku është ndertuar objekti ekzistues si dhe pritet të ndërtohet dhe një shtese e këtij objekti (ambjente shtese për palester). Kjo përfshin analiza të dheut dhe ujërave nën sipërfaqe për të vlerësuar stabilitetin dhe sigurinë e mundshme gjatë ndërtimit dhe përdorimit të godines. Gjithashtu inxhinieri gjeolog identifikon dhe vlerëson mundësinë e fenomeneve natyrore të tilla si rrëshqitje dheu, përmbytje dhe tërmete të cilat ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e godines.

- 1 (nje) Inxhinier Mekanik

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat.4.b. Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi; Kat.4.f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit; si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”,i ndryshuar , per te hartuar raportet e detajuara të sistemit ngrohës (ngrohje qëndrore) duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes, por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së liçencës së kërkuar Kat.4.c Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.; si dhe të impianteve të prodhimit të

energjisë termike nga burime të rinovueshme; si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar , për të hartuar raportet e detajuara të linjes së rrjetit elektrik sipas detyrës së projektimit.

- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

-Gjykohet i nevojshëm sipas përcaktimeve të pikës së licencës së kërkuar Kat.4.j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial; si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; si dhe referuar detyrës së projektimit ku në mbështetje të VKM - së Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar , për të hartuar raportet e detajuara

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndihmës si më poshtë, vërtetuar me Kontratë pune individuale të vlefshme/ Kontratë Bashkëpunimi, diplomë, licensë profesionale individuale, CV.

- 1 (nje) Arkitekt

-1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Secili anëtar i stafit të deklaruar duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Specialistet e fushës për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mesipër ndihmes është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjes të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas detyrës së projektimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin që pritet të jetë i angazhuar në këtë procedurë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personel të certifikuar, si më poshtë:

-1 (nje) punonjes të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

-1 (nje) Auditues energjitik i Certifikuar nga Agjensia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në Ndertesa;

-1 (nje) Ekspert Zjarrefikes

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV, Certifikatat përkatëse (të vlefshme) dhe license.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Specialistet e fushës për vendosjen e këtij kriteri i janë referuar detyres së projektimit, pjesë e kësaj procedure dhe si e tillë kërkohej disponimi: -1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis;-1 (nje) Auditues energjitik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;-1 (nje) Ekspert Zjarrefikes .

Ky staf gjykohej i domosdoshem per hartimin e raporteve te ndikimit ne mjedis (VNM), raportit te eficences se energjise si dhe raportit per projektin e mbrojtjes nga zjarri.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesemarres duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte:

- Certifikatë Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente;
- Certifikate Per Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, ISO 14001 - 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente .
- Certifikatë Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Pune, ISO 45001-2018 ose ekuivalente
- Certifikate Per Sistemin e Menaxhimit të Energjisë ISO 50001:2018 (e vlefshme) ose ekuivalente;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit (DPA),ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”Çertifikatat e cilësisë janë në perputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

-ISO 9001 : 2015, “Për menaxhimin e cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalente .

Çertifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (Quality Management System – QMS) : Ky standart ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë dhe sigurimi e proceseve të projektit. Çertifikimi sipas ISO 9001 konfirmon se studioja ka vendosur standarte të larta për proceset e saj dhe ka një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë.

- ISO 14001 : 2015, “Për menaxhimin e Mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalente .

Çertifikata e Sistemit të Menaxhimit të Ambientit (Environmental Management System – EMS). Një studio projektuese që merret me dizenjimin e projekteve ndikon në ambient, kështu që çertifikimi sipas ISO 14001 tregon angazhimin për pasurimin e mjedisit dhe minimizimin e ndikimeve negative në të.

-ISO 45001 : 2018 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë” (e vlefshme) ose ekuivalente

Çertifikata e Sistemit të Menaxhimit të të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (Occupational Health and safety Management Systems – OHSMS). Ky standart konfirmon se studioja ndjek një sistem efektiv të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve të saj duke garantuar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm për ekipin e saj.

-ISO 50001:2018 “Sistemi i Menaxhimit të Energjisë” (e vlefshme) ose ekuivalente

Çertifikata e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë është një standart që konfirmon se studioja ndjek një sistem efektiv të menaxhimit të energjisë duke garantuar një menaxhim të sigurt dhe me efikasitet në energji.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;

-1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Këto pajisje kërkohen për të kryer matjet topografike dhe rlevimet që lidhen me përcaktimin e gjurmës dhe kuotave topografike për objektin që do të behet projektimi.

2.3.9 Operatorët ekonomik, në përmbushje të pikës 4.4, germa A) e DST duhet të paraqesin (i) *Përvoja për Punë të Ngjashme të Operatorit Ekonomik*, (ii) *Metodologjia e Propozuar*, (iii) *Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar* për qëllim të vlerësimit me pike të propozimit teknik.

SHËNIM:

-Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre ekonomike/financiare duhet të referohen VKM Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me nr. 5585 Prot”, Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot të APP.

-Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” .

Argumentimi: Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4 dhe 9, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2. Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomike më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.

Formula e llogaritjes është:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \text{Çu}$$

Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me nr. 5585 Prot", Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot të APP.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjesë e DT.

Njësia e Prokurimit: